

REPUBLIKA SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

Nr. 3183 Rep.

Nr. — Kol.



KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Ne Tirane sot , me date 25 / 7 / 2003 (dy mije e tre) , perpara meje noteres N. Murat me studio ne Tirane , Bul. Gjergj Fishta u paraqiten palet kontraktuese si me poshte :

SHITES :

1. **Sizajete GURI** , e bija e Kasemit , e dtl. 1955 , lindur dhe banuese ne Vlore , Lajia pavaresia , pall. 1383 . Madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me dokument identifikimi perkates . Nen cilesine e Ortakut te Vetem te Shoqerise **ERJONI Sh.p.k.**

BLERES :

1. **Irfan HYSENBELLIU** , i biri i Hasanit , i dtl. 1959, lindur ne Skrapar dhe banues ne Tirane , Rr. Pjeter Bogdani , Pall.11, Ap.6 . Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me dokument identifikimi (pasaporta) Nr. 299990 .

Zj. Sizajete GURI eshte Ortake e Vetme dhe Administratore e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **ERJONI Sh.p.k.** (ne baze te vendimit Nr. 7877/1 date 24.07.2000) person juridik shqiptar rregjistruar prane Gjykates se Rrethit Tirane me **Vendimin Nr. 7877 date 05.01.1995**, me Seli ne Vlore , me kapital themeltar **100.000 leke** .

Shitesia **Sizajete GURI** ka vendosur te shesi te gjitha kuotat e saj te kapitalit themeltar te cilat i disponon ne masen 100 % me vlere nominale prej **100.000 leke** Bleresit **Irfan HYSENBELLIU** shume e cila u likujdua menjehere nga Bleresi .

Me shitjen e kuotave te saj te kapitalit themeltar **zj. Sizajete GURI** largohet nga **Shoqeria** .

Me Blerjen e ketyre kuotave te kapitalit themeltar nga **z. Irfan HYSENBELLIU** ne Shoqerine e lartepermendur behet Ortak i Vetem dhe Administrator i Shoqerise **ERJONI Sh.p.k.** .

Kjo kontrate pasi iu lexua paleve dhe pasi u gjet sipas vullnetit te tyre nenshkruhet rregullisht perpara meje noteres dhe une ne baze te ligjit e vertetoj ate .


PALET KONTRAKTUESE

SHITES

Sizajete GURI

BLERES

Irfan HYSENBELLIU



7877/3

KERKESE

8 A. C. C. C.
27 MAG 2002
2002

KERKUESE : Sizajete GURI , e bija e Kasemit , e dtl. 1955 , lindur dhe banuese ne Vlore , Lagjia Pavaresia , pall. 1383 . Madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar . Nen cilesine e ortakes se vetme dhe Administratores se Shoqerise " ERJONI " Sh.p.k.

OBJEKTI : Kerkohet prishja me nenvizim e regjistrimit te paligjshem per mungese kushti themelor , te bera me vendimin Nr. 7877/2 date 31.10.2001 te gjyqtares se vetme me kekesen e ish ortakut themelues te kesaj shoqerie z. Ylli GURI .

Baza Ligjore : Neni 19 i Ligjit i Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin Tregetar " dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare " .

Perpara : GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
(Seksioni Tregetar)

TIRANE

- Me Vendimin Nr. 7877 date 05.01.1995 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare me pergjegjesi te kufizuar " ERJONI " Sh.p.k. me ortak te vetem themelues dhe Administrator, z. Ylli GURI , me kapital themeltar 100.000 leke dhe seli ne qytetin e Vlores .
- Me pas , me Vendimin Nr. 7877/1 date 26.07.2000 eshte vendosur depozitimi i Vendimit Nr. 1 date 20.07.2000 ortakut te vetem te shoqerise " ERJONI " Sh.p.k. ku behet fjale per largimin e z. Ylli GURI si ortak dhe Administrator nga kjo shoqeri dhe pranimin e zj. Sizajete GURI si ortak e vetme dhe Administratore e Shoqerise ERJONI Sh.p.k. Z. Ylli GURI eshte emeruar si Drejtues Teknik i Shoqerise pasi aktiviteti i kesaj shoqerie do te ishte kryesisht ne ate te fushes se ndertimit . Per te plotesuar praktiken ne baze te ligjit eshte redaktuar edhe Kontrata e shit- blerjes se kuotave te kapitalit themeltar me Nr. 1466 Rep dhe Nr. 131 Kol. tek Notere Lumturi CULAJ ku behet fjale qe Bleresia Sizajete GURI i ble 100 % kuotat e kapitalit themeltar te Shoqerise ERJONI Sh.p.k. nga shitesi Z. Ylli GURI .
- Ne vijim , gjyqtarja e vetme , me Vendimin Nr. 7877/2 date 31.10.2001 ka vendosur :
 - Pranimin e kerkeses se paraqitur nga ana e " Administratorit " z. Ylli GURI .
 - Depozitimin e vendimit te ortakut te vetem te shoqerise " ERJONI " Sh.p.k. date 25.10.2001 i cili ka vendosur shitjen e " kuotave te zotemara prej tij ne masen 100 % " bleresit z. Irfan HYSENBELLIU .
- Kerkojme , pikerisht prishjen me nenvizim te regjistrimit ne Rregjistrin tregetar te vendimit te mesiperm per aresyet e meposhteme :





- Nga kronologjia e tere praktikes se Shoqerise "ERJONI" Sh.p.k. rezulton se ne baze te ligjit te drejten per te marre vendime lidhur me shitjen , tjetersimet apo cfaredolloj ndryshimi ne shoqerine e mesiperme e ka vetem ortakja e veteme dhe Administratoia e ligjshme **zj. Sizajete GURI** . (*Permendim perseri qe z. Ylli GURI eshte larguar nga kjo shoqeri ne baze te vendimit Nr. 7877/1 date 26.07.2000 te Gjykates se Rrethit Tirane*) .

Pra, ne menyre te kundraligjshme z. Ylli GURI i ka dhene vetes perseri cilesine e Ortakut te vetem dhe Administratorit te shoqerise duke firmosur Vendimin e Ortakut te vetem lidhur me vendimmarrjen e shitjes se kuotave ne masen 100 % z. **Irfan HYSENBELLIU** .

Perseri , ne menyre te kundraligjshme , z. Ylli GURI ka nenshkruar Kontraten e Shit-Blerjes se Kuotave me **Nr. 9157 Kol dhe Nr. 1363 Rep. tek Noter Agim ROBO** ku behet fjale per shitblerjen e te gjitha kuotave te **ERJONI Sh.p.k.**

- Dhe , se fundi nen cilesine e " Administratorit " ka paraqitur kerkesen perkatese per depozitim ne Gjykatën e Rrethit Tirane , e cila me Vendimin e saj Nr. 7877/2 date 31.10.2001 pa patur asnje nga kushtet themelore ligjore te mesiperme ka vendosur depozitim e dokumentave .

Ne perfundim , per sa siper e quaj te paligjshem regjistrimin e ndryshimeve te bera me Vendimin **Nr. 7877/2 date 31.10.2001** te gjyqtarit te vetem dhe kerkoj prishjen me nenvizim te ketyre regjistrimeve per mungese te kushteve themelore.

KERKUESE

Sizajete GURI

Ortake e vetme dhe Administratore
E Shoqerise "ERJONI" Sh.p.k.

(Sizajete Guri)
[Signature]